



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
BORDI

VENDIM

Nr. 143, Datë 06.06.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 380, SERIA T17, PËR  
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË  
SHOQËRISË “ALIN TRADING” SH.P.K. ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR.  
137, DATË 06.09.2017**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5, gërma “ç”, nenit 6 dhe 7, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; pikës 3.8 dhe pikës 5.1, gërma “ç”, të “Kushteve të licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.06.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 866/8 prot., datë 02.06.2022, të përgatitur nga Grupi i Punës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit të vitit 2021”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ALIN TRADING” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 380, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 137, datë 06.09.2017, për një afat 5-vjeçar.
- Me vendimin e bordit nr. 142, datë 15.06.2021, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2021 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror. Vendimi nr. 142/2021 i bordit të ERE-s është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 103, datë 29.06.2021. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 842/8 prot., datë 21.07.2021. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi për shlyerjen e debisë nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1016/10 prot., datë 21.10.2021.
- Me Urdhrin e Kryetarit nr. 53, datë 07.04.2022, “Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve për pagesat e rregullimit të vitit 2021 të pashlyera ndaj ERE-s” u ngrit grupi i punës për fillimin e hetimit administrativ ndaj shoqërive të licencuara, që nuk kanë përmbushur detyrimin si më sipër, me qëllim përcaktimin e fakteve dhe rrethanave që kanë çuar në mosshlyerjen e pagesës rregullatore të vitit 2021 për llogari të ERE-s.

- Shoqërisë “ALIN TRADING” sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 517 prot., datë 13.04.2022, duke i bërë me dije fillimin e hetimit administrativ dhe duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s për pagesën e rregullimit të vitit 2021. Bashkë me këtë informacion, shoqërisë iu kërkuar që të përcjellë në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t’i shërbente hetimit administrativ të filluar më urdhrin e kryetarit. Në përfundim të afateve të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti “ALIN TRADING” sh.p.k. nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar. Për sa më sipër rezultoi se grupi i punës ka konstatuar nga ana e këtij të licencuari shkeljen si vijon: *Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2021.*
- Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se, për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në gërmën “ç”, të nenit 42, parashikohet se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji. Neni 6, i “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.04.2017, parashikon se: *Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijëni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit nr. 43/2015, e cila përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.* Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit, është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijëni në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të vendimit për pagesat e rregullimit për vitin 2021, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijëni nga ERE, sikurse cituar më sipër.
- Referuar parashikimeve të “Rregullores mbi përcaktimin e miratimit të pagesave rregullatore dhe kushteve të licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike”, përlllogaritja e masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Shoqëria “ALIN TRADING” sh.p.k. nuk rezultoi të ketë patur aktivitet në vitin paraardhës të vendosjes së detyrimit për shlyerjen e pagesës rregullatore ndaj për këtë subjekt nuk mund të aplikohet masa administrative e gjobës, që parashikon ligji nr. 43/2015, në rrethanat e konstatimit të kësaj shkeljeje. Gjithashtu mungesa e reagimit nga ana e të licencuarit, për të dhënë shpjegime në lidhje me pengesat që kanë shkaktuar shkeljen e detyrimeve me të cilat i ngarkon ligji dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij, është shmangie nga detyrimi që ka çdo i licencuar për të informuar ERE-n.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 380, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “ALIN TRADING” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 137, datë 06.09.2017.
2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.
3. Grupi i Punës, të njoftojë shoqërinë “ALIN TRADING” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**